



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
DREJTORIA E PROGRAMEVE TË ZHVILLIMIT TË INDUSTRIËS DHE ENERGJISË**

URDHËR
NR. 246, DATË 12. 3. 2018

PËR
MIRATIMIN E RREGULLORES PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE TË
MIRATIMIT TË MARRËVESHJES HIDROKARBURE, LICENCË
MARRËVESHJES SI DHE AFATET PËRKATËSE

Në mbështetje të pikës 2, të nenit 5 dhe pikës f, të nenit 9 të ligjit nr. 7746, datë 28.7.1993
"Për hidrokarburet (kërkimi dhe prodhimi), të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Miratimin e rregullore për përcaktimin e procedurave të miratimit të marrëveshjes hidrokarbure, licencë marrëveshjes si dhe afatet përkatëse, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij Urdhri.
2. "Rregullorja për procedurat e miratimit të marrëveshjeve hidrokarbure dhe licencë marrëveshjeve, si dhe afatet përkatëse", ndryshuar me Urdhrin e Ministrit nr. 121, datë 08.05.2015, shfuqizohet.
3. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen strukturat përgjegjëse për sektorin hidrokarbur dhe juridik në MIE, AKBN dhe shoqëria Albpetrol sh.a.
4. Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI

Damian Gjoknari

RREGULLORE
PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE TË MIRATIMIT TË
MARRËVESHJES HIDROKARBURE, LICENCË MARRËVESHJES SI DHE
AFATET PËRKATËSE

I. Procedurat për iniciimin e marrëveshjeve hidrokarbure për kërkimin, zhvillimin dhe prodhimin e hidrokarbureve bëhen si më poshtë:

1. Me iniciativë të ministrisë përgjegjëse për hidrokarburet (Ministria), nëpërmjet një njoftimi për të ftuar subjektet e interesuara për pjesëmarrje me anën e aplikimeve. Ministria, AKBN dhe Albpetrol Sh.A. (në rastin e zonave që administrohen nga Albpetrol) në këtë rast publikojnë në faqen e tyre të internetit hartën me blloqet e lira apo vendburim/e të naftës dhe gazit në territorin e Republikës së Shqipërisë për të ftuar subjektet e interesuara për pjesëmarrje me anën e aplikimeve, si dhe formularin e aplikimit. Në formatin e aplikimit duhet të përfshihet edhe afati i dorëzimit të aplikimeve për bllokun/blloqet e lira apo vendburimin/et.
2. Me njoftim të Ministrisë, për të ftuar subjekte të tjera për aplikime, pas dorëzimit të kërkesës, në Ministri, AKBN ose Albpetrol (në rastin e zonave që administrohen nga Albpetrol), nga një subjekt për një bllok/blloqe apo vendburim/e të caktuar/a për të cilët nuk ka një njoftim të publikuar. Afati kohor i kësaj ftese është jo më pak se 90 ditë, duke filluar nga data e njoftimit. Ky njoftim publikohet në faqen e internetit të ministrisë, AKBN dhe Albpetrol.

II. Procedura për përgatitjen dhe miratimin e një Marrëveshje Hidrokarbure, nga Ministria, AKBN dhe Albpetrol, sipas zonave që kanë në administrim si dhe afatet kohore të miratimit të tyre janë si më poshtë:

1. Subjektet e interesuara paraqesin pranë Ministrisë, AKBN ose Albpetrol (në rastin e zonave që administrohen nga Albpetrol) një aplikim për të hyrë në Marrëveshje Hidrokarbure. Në rast aplikimi në Ministri, ai dërgohet për shqyrtim në AKBN ose Albpetrol brenda 10 ditëve.

2. AKBN ose Albpetrol shqyrton aplikimin sipas procedurës së mëposhtme:

i. Në rastin kur në AKBN ose Albpetrol ka aplikim nga një subjekt i vetëm për një bllok ose vendburim të lirë, AKBN ose Albpetrol sipas rastit, brenda 10 ditëve nga marrja e aplikimit, pas afateve kohore të përcaktuar në pikën 1, paraqet në Ministri dokumentacionin e nevojshëm, se bashku me vlerësimin për kapacitetet teknike dhe financiare, si dhe kërkesën për miratimin e fillimit të negociimeve. Ministria jep aprovimin ose jo për fillimin e negociatave brenda 20 ditëve nga marrja e propozimit nga AKBN ose Albpetrol.

ii. Në rast se, ka më shumë se një aplikim për një bllok ose vendburim të lirë, AKBN ose Albpetrol sipas rastit, përcjellin në Ministri dokumentacionin e shoqërive aplikuese dhe

